

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Enver Peci Kryetar i Gjykatës-kolegjit, Emine Mustafa dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit I.L. nga fshati P., komuna e D. etj., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të pandehurit I.L., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-DKR Pkr.nr.57/2017 datë 04.09.2017. në seancën e kolegjit të mbajtur më 30.10 2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit I.L., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Gjilan Pkr.nr.57/2017 datë 04.09.2017.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – DKR, me aktvendimin Pkr.nr.57/2017 datë 04.09.2015, të pandehurve I.L. dhe Sh.L., u ka vazhduar masën e paraburgimit, ndërsa të pandehurit N.B. masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, gjegjësisht deri më datë 03.11.2017, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, Paraburgimi dhe arresti u është vazhduar të pandehurve konform dispozitës së nenit 183 gjegjësisht nenit 187 par.1 nënpar.1.1 e 1.2 pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i pandehuri I.L., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, nga neni 187 par.1, nënëpar.1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3. të KPPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoi kërkesën e

të pandehurit si të bazuar, ta ndryshoj aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - DKR Pkr.nr.57/17 datë 04.09.2017, ashtu që të pandehurin ta liroj nga paraburgimi dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit, ka dhënë Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.III.nr.76/2017 datë 26.10.2017, në të cilën propozon që kërkesa e të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa e të pandehurit nuk është e bazuar.

I pandehuri në kërkesën e tij pretendon se si Gjykata Themelore në Gjilan në aktvendimin saj ka gjetur se ndaj të pandehurit I.L., ende ekzistojnë arsytet ligjore për vazhdimin e paraburgimit për shkak të veprës penale për të cilin është ngritur aktakuza dhe është duke rrjedhur procedura penale edhe pse me asnjë fjalë nuk arsyetohet se si dhe pse mund të ik-arratiset apo të përsërisë veprën tjetër penale, kur i pandehuri ka pranuar se është bashkëkryes i kësaj vepre penale, dihet identiteti dhe vendbanimi i tij, se përmes thirrjes telefonike është paraqitur në polici, se është familjar dhe se asnjë arsye nuk ka që të ik apo t'u shmanget organeve të drejtësisë. Po ashtu i pandehuri thekson në kërkesë se është i befasuar për faktin se si dy bashkëkryerësit M.L. dhe Xh.R., të kësaj vepre penale edhe pse janë shtetas të R.Serbisë, lihen për t'u mbrojtur në liri, ndërsa i pandehuri I.L., edhe pse është shtetas i Kosovës, po për të njëjtën vepër penale mbahet ende në paraburgim.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet në kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk qëndrojnë, për faktin se siç rezulton nga shkresat e çështjes, procesi penal gjendet në fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe se nga rrjedha e mëtutjeshme e saj do të shihet se çfarë epilogu do merr kjo çështje penalo-juridike. Rrjedhimisht edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, qëndrojnë bazat ligjore për vazhdimin e paraburgimit sipas dispozitës së nenit 187

par.1, nënpar.1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3. të KPPK-së, siç me të drejtë ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, e të cilat vlerësime si të drejta dhe ligjore i pranon edhe kjo Gjykatë.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se ndaj të pandehurit është ngrit aktakuza, se për këtë veprë penale parashihet dënim mjaft i lartë, dënim me gjobë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) deri në 12 (dymbëdhjetë) vite, janë arsye të mjaftueshme për të justifikuar frikën se me gjetjen e tij në liri apo nënë ndonjë masë tjetër më të butë për sigurimin e prezencës së tij në procedurë, do të jetë i pa arritshëm për organet e drejtësisë, për çka qëndron baza ligjore për vazhdimin e mëtutjeshëm të paraburgimit nga dispozita e nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të KPPK-së.

Po ashtu, qëndron baza për vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit I.L. edhe sipas dispozitës së nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke marr parasysh natyrën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale duke vepruar në bashkëveprim, motivi që i ka paraprirë veprës penale, përfitimi i planifikuar i kundërligjshëm pasuror, sasia e madhe e substancave narkotike në peshë prej 240.723.6 gram e ndarë në 234 paketime, pastaj duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore e sidomos pasojat që mund të shkaktohen sidomos te moshat e reja dhe dukurisë së shtimit të rasteve të këtyre veprave penale, janë rrethana që tregojnë rrezikun se po të gjendej i pandehuri në liri i njëjti mund të përsërisë vepra të tilla penale apo të ngjashme.

Nga arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurale, siç i pandehuri pretendon në kërkesë sepse gjykata e shkallës së parë me vendimin e saj ka bërë vlerësimin e pretendimeve dhe ka dhënë arsyetimin e duhur, vlerësime si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë për sigurimi e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.296/2017, më 30.10.2017

B.profesional  
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,  
Enver Peci